

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010), dhe nenet 16 dhe 85 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11 / 11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28 janar 2016 miratoi si vijon:

RREGULLORE PËR PËRDORIMIN E VLERËSIMEVE TË JASHTME KREDITORE PËR QËLLIM TË LLOGARITJES SË KAPITALIT RREGULLATIV

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat dhe kriteret për përdorimin e vlerësimeve nga institucionet për vlerësime të jashtme kreditore, për përcaktimin e peshave me rrezik ndaj mjeteve, gjatë llogaritjes së kërkesave për kapital minimal rregullativ për rrezikun kreditor sipas qasjes së standardizuar të Shtyllës I të Standardeve të Basel-it për Kapital.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja që operojnë në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjithë termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termat e përcaktuar në nenin 3 të Ligjit nr.04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (në vijim: *Ligji për bankat*) dhe / ose me përkufizimet në vijim për qëllim të kësaj rregulloreje:

- 1.1. **Institucioni për vlerësimin e jashtëm kreditor** (në vijim: IVJK) – është personi juridik, i cili përgatit dhe lëshon në baza profesionale, vlerësimin kreditor **të kërkuar** apo **të dhënë**, me qëllim të vlerësimit të rrezikut kreditor.
- 1.2. **IVJK i pranuar** – është institucioni për vlerësimin e jashtëm kreditor, i njohur nga BQK-ja. Për qëllime të përlllogaritjes së kërkesës për kapital, bankat mund të përdorin vetëm vlerësimet kreditore të IVJK-ve të pranuar nga BQK-ja.

- 1.3. **IVJK i emëruar** – është IVJK i pranuar, i cili është emëruar nga banka komerciale në pajtueshmëri me rregulloret e brendshme të saj, vlerësimet e të cilit banka ka vendosur t'i përdorë për qëllime të përcaktimit të peshave me rrezik sipas kërkesave të Rregullores së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit.
- 1.4. **Agjencia e kreditimit të eksporteve** – (në vijim: AKE) – është agjencia që mbështet aktivitetet e eksportit, të personave fizikë dhe juridikë, nga vendet në të cilat AKE është e regjistruar. AKE-të ofrojnë kredi të garantuara nga qeveritë, garanci dhe sigurime që mbulojnë si rrezikun tregtar dhe atë politik, të vendit që merr hua. Bankat në llogaritjen e kërkesës për kapital, mund të përdorin vlerësimet kreditore, të publikuara nga AKE-të, në rast se ato përmbushin kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.
- 1.5. **AKE e njohur** – vlerësimet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Evropian (OBZHE).
- 1.6. **Vlerësimi kreditor** – është një opinion në lidhje me aftësinë kreditore/paguese të një subjekti, një borxhi apo detyrimi financiar, letre me vlerë të borxhit, aksioni preferencial apo ndonjë instrumenti tjetër financiar, apo të një emetuesi të njërit nga këto instrumente financiare, duke përdorur një sistem të themeluar dhe të përcaktuar të kategorizimit të klasifikimeve kreditore. Vlerësimi kreditor mund të jetë **i kërkuar** (solicited rating) apo **i dhënë** (unsolicited rating).
- 1.7. **Vlerësimi i kërkuar** – është çdo vlerësim i lëshuar nga një IVJK e pranuar, me kërkesën e institucionit/subjektit që vlerësohet, kundrejt pagesës së një tarife.
- 1.8. **Vlerësimi i dhënë** – është një vlerësim i lëshuar nga një IVJK e pranuar, pa kërkesën e institucionit/subjektit që vlerësohet dhe pa pagesë të ndonjë tarife.
- 1.9. **Llojet e vlerësimit kreditor janë:**
- vlerësimet kreditore afatshkurta dhe afatgjata;
 - vlerësimi kreditor i një kredimarrësi dhe vlerësimi kreditor i një instrumenti financiar;
 - vlerësimet kreditore për segmentet e tregut.
- 1.10. **Mapingu i vlerësimit të rrezikut kreditor** – është një procedurë ku vlerësimi kreditor individual nga një IVJK e pranuar ndërlidhet me kategoritë e kualitetit të vlerësimit kreditor të specifikuar sipas qasjes së standardizuar të Shtyllës I të Kornizës së Bazelit.
- 1.11. **Segmentet e tregut përfshijnë:**
- Segmentet kryesore të tregut;
 - Një grup subjektësh dhe/apo instrumente financiare ku një IVJK e pranuar aplikon të njëjtën metodologji dhe procedurë për lëshimin, rilëshimin apo revokimin e vlerësimit kreditor.

1.12. Segmentet kryesore të tregut janë:

- **Institucionet publike** (qeveria qendrore, banka qendrore, institucionet publike, qeveria lokale) dhe instrumentet financiare të lëshuara nga këto subjekte (me përjashtim të produkteve financiare të strukturuar);
- **Shoqëritë tregtare** – subjektet ligjore të sektorit publik apo privat që operojnë në baza komerciale dhe instrumentet financiare të lëshuara nga këto subjekte (me përjashtim të produkteve financiare të strukturuar);
- **Produktet financiare të strukturuar** – të gjitha produktet e lëshuara financiare të strukturuar, pavarësisht emetuesit, duke përfshirë edhe produktet e sekjuritizimit.

Neni 3

Njohja e institucioneve për vlerësime të jashtme kreditore

1. Bankat për të përcaktuar peshën e rrezikut të një ose disa ekspozimeve, duhet të përdorin vetëm vlerësimet e IVJK-ve të cilat njihen nga BQK-ja si të pranueshme për këtë qëllim.
2. BQK-ja mund të njohë IVJK-në në njërin nga këto dy mënyra:
 - 2.1. Njohja indirekte** në rastet kur BQK-ja pranon një IVJK duke mos zbatuar procesin e saj të vlerësimit. Procedurat për njohjen indirekte mund t'i përdorin IVJK-të e pranuar nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian bazuar në dispozitat e Rregullores 1060/2009 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian.
 - 2.2. Njohja direkte** në rastet kur BQK-ja kryen vlerësimin e saj për njohjen e IVJK-së.
3. Çdo IVJK, vlerësimet e të cilës do të përdoren nga një bankë për qëllime të kësaj rregulloreje, duhet të paraqesin kërkesën e aplikimit në BQK për njohjen e saj. (Aneksi 1)
4. Si pjesë e njohjes indirekte të IVJK-së, BQK-ja lejon njohje të menjëhershme dhe automatike të institucioneve si vijon: “Fitch Ratings”, “Moody’s” dhe “Standard & Poor’s”, në këtë mënyrë këto institucione nuk do të jenë të obliguara të kalojnë nëpër procedurën e aplikimit të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.
5. Për çdo IVJK e cila nuk kualifikohet automatikisht për njohje (indirekte) nga BQK-ja, duhet të kërkojë njohje direkte apo indirekte sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore.
6. BQK-ja do ta njohë një IVJK si të pranuar në kuadër të njohjes direkte vetëm kur konstatohet se metodologjia e vlerësimit të IVJK-së është në pajtueshmëri me kërkesat e objektivitetit, pavarësisht, rishikimit të vazhdueshëm dhe se rezultatet e vlerësimeve kreditore përmbushin kërkesat e besueshmërisë dhe transparencës, si dhe kriteret teknike të përcaktuara në këtë rregullore.
7. BQK-ja, në rastin kur një IVJK është e njohur si e pranuar nga autoritetet kompetente të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian, mund ta njohë atë si të pranueshme, pa kryerjen e procesit të saj të vlerësimit.
8. BQK-ja mund të nxjerrë udhëzime shtesë mbi procesin e njohjes së IVJK-së/ve dhe një listë të IVJK-ve të pranuar.

Neni 4 Kriteret teknike për njohjen e IVJK-ve

IVJK për qëllim të njohjes nga BQK-ja, duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

1. **Objektiviteti:** Metodologjia e përdorur nga IVJK-ja për caktimin e vlerësimeve kreditore duhet të jetë rigoroze, sistematike e vazhdueshme dhe t'i nënshtrohet vlefshmërisë, bazuar në përvojën historike. BQK-ja, për të vërtetuar plotësimin e këtyre kërkesave, kërkon nga IVJK plotësimin e kushteve të mëposhtme:
 - 1.1. metodologjia e përdorur duhet të marrë në konsideratë faktorët që bëjnë diferencimin e karakteristikave specifike të pozicioneve të ndryshme të vlerësuara sipas kësaj metodologjie (procesi i njohjes nuk ka për qëllim të verifikojë saktësinë e metodologjisë, por kjo e fundit duhet të mbështetet me evidencat statistikore nga përdorimi i saj në të kaluarën);
 - 1.2. aftësia shpjeguese e metodologjisë duhet të mbështetet në të dhëna të disponueshme mbi normat e dështimit, të regjistruara për shkallët e vlerësimit individual dhe normat e migrimit, ndërmjet shkallëve të ndryshme të vlerësimit;
 - 1.3. metodologjia duhet të zbatohet në mënyrë konsistente ndaj të gjitha ekspozimeve në një klasë të caktuar dhe duhet të bëjë diferencimet e duhura, ndërmjet ekspozimeve në klasa të ndryshme;
 - 1.4. metodologjia duhet të validohet brenda institucionit (IVJK-së) në bazë të përvojës historike; dhe
 - 1.5. metodologjia duhet të korrigjohet bazuar në gabimet sistematike të identifikuara gjatë ritestimit.
2. **Pavarësia:** Metodologjia duhet të jetë e pavarur nga ndikimet ose kufizimet e jashtme politike dhe nga konfliktet e interesit ose presionet ekonomike, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin kreditor. BQK-ja për të verifikuar plotësimin e kësaj kërkesë, kërkon nga IVJK-ja që të përmbushë këto kushte:
 - 2.1. janë marrë masat e nevojshme për të siguruar pavarësinë nga pronësia dhe për të parandaluar presionet ose kufizimet e jashtme politike apo ekonomike, të cilat mund të rrezikojnë objektivitetin e vlerësimit kreditor;
 - 2.2. struktura organizative nga pikëpamja operative siguron burimet njerëzore dhe mundësitë ligjore, ndarjen e veprimtarisë së vlerësimit kreditor nga veprimtaritë e tjera, të tilla si këshillimi dhe marketingu, të cilat mund të ndikojnë në objektivitetin e vlerësimit;
 - 2.3. janë miratuar rregulla të brendshme për të parandaluar konfliktet e interesit në lidhje me personat e përfshirë në vendosjen e vlerësimeve;
 - 2.4. veprimtaria e vlerësimit është fitimprurëse dhe IVJK ka burime financiare të mjaftueshme në dispozicion;
 - 2.5. struktura e tarifave të ngarkuara për subjektet e vlerësuara dhe kompensimi i personelit përgjegjës për caktimin e vlerësimeve, nuk ndikohen nga rezultati i vlerësimit dhe anasjelltas;
 - 2.6. janë marrë masat e nevojshme për të siguruar pavarësinë në dhënien e vlerësimeve nga klientët kryesorë, të cilët gjenerojnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave (e cila përbën më tepër se 5% të të ardhurave);
 - 2.7. ka staf të mjaftueshëm me një nivel të duhur të ekspertizës dhe përvojës profesionale

në kryerjen e vlerësimeve kreditore (për shembull të paktën një nga personat që marrin pjesë në një vendim vlerësimi, duhet të ketë të paktën një përvojë prej tri viteve). Numri i personelit duhet të jetë adekuat për vëllimin e biznesit të kryer, duke pasur parasysh gjithashtu, nevojën për të mbajtur kontakte të vazhdueshme me subjektet e vlerësuara, atje ku kjo është pjesë e metodologjisë së përdorur;

- 2.8. ka formalizuar rregullat e brendshme të qeverisjes në mënyrë të qartë;
 - 2.9. shpalos në mënyrë të duhur çfarëdo konflikti të interesit; dhe
 - 2.10. ka një funksion të auditimit të brendshëm (ose funksione të tjera të ngjashme), që është i pavarur nga personat përgjegjës për caktimin e vlerësimeve dhe që është ngarkuar me verifikimin e zbatimit efektiv të kushteve të pavarësisë.
3. **Rishikimi i vazhdueshëm:** Vlerësimet kreditore të IVJK-së i nënshtrohen rishikimit të vazhdueshëm dhe i përgjigjen ndryshimeve në kushtet financiare. BQK-ja për të vërtetuar plotësimin e kësaj kërkesë, kërkon nga IVJK që të përmbushë kushtet e mëposhtme:
- 3.1. IVJK-ja disponon procedura për të monitoruar çdo ndryshim në njësitë ekonomike të vlerësuara, gjë që mund të çojë në ndryshime të rëndësishme të vlerësimit dhe nëse është e nevojshme, të mund të ndryshojë në mënyrë të menjëhershme vlerësimin/et;
 - 3.2. IVJK-ja disponon një procedurë të aplikuar të ritestimit (*back-testing*) e cila së paku ekziston për një periudhë njëvjeçare; dhe
 - 3.3. Vlerësimet kreditore shqyrtohen, së paku një herë në vit.
4. **Besueshmëria e tregut:** Vlerësimet individuale kreditore nga ana e IVJK-së, janë të njohura në treg si të besueshme nga përdoruesit e vlerësimeve të tilla. BQK-ja vlerëson kriterin e besueshmërisë, duke u bazuar në faktorë të tillë si:
- 4.1. pjesa e tregut që mbulon IVJK;
 - 4.2. të ardhurat e krijuara nga IVJK-ja dhe në përgjithësi, burimet financiare të saj;
 - 4.3. nëse vendosja/përcaktimi i çmimeve/tarifave bëhet në bazë të vlerësimeve; dhe
 - 4.4. të paktën dy banka përdorin vlerësimin individual të saj (IVJK-së) për emetimin e obligacioneve dhe/ose vlerësimin e rrezikut kreditor.
5. **Transparenca e metodologjisë dhe vlerësimeve kreditore:** BQK-ja, në procesin e njohjes së një IVJK-je, kërkon që:
- 5.1. IVJK-ja të bëjë publike parimet e metodologjisë së vlerësimit dhe çdo ndryshim në metodologji, në atë mënyrë që të jetë e kuptueshme për përdoruesit e vlerësimeve kreditore;
 - 5.2. Vlerësimet individuale kreditore të jenë të qasshme në kohën e duhur dhe për të gjitha bankat që kanë interesa legjitime për këto vlerësime kreditore; dhe
 - 5.3. Në veçanti, vlerësimet individuale kreditore të jenë të disponueshme për bankat e huaja (jovendore), në mënyrë të barabartë me bankat vendore, që kanë interesa legjitime për këto vlerësime kreditore.

Neni 5

Mapingu i vlerësimeve kreditore të IVJK-ve

1. BQK-ja duke marrë parasysh kriteret teknike të përcaktuara në këtë rregullore për njohjen e IVJK-ve, përcakton procesin e ndërlidhjes/mapingut ndërmjet shkallës së cilësisë së kredisë dhe vlerësimeve përkatëse kreditore të një IVJK-je të njohur. *Mapingu* i BQK-së për njohjet indirekte, si dhe për njohjet direkte të IVJK-ve përcaktohet me rregulloren e BQK-së për adekuatëshmërinë e kapitalit të bankave.

2. Në rastin kur autoritetet kompetente të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian kanë bërë një përcaktim në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, BQK-ja mund të pranojë përcaktimin pa kryer procesin e saj të përcaktimit të ndërlidhjes ndërmjet shkallës së cilësisë së kredisë dhe vlerësimeve përkatëse kreditore.
3. Procesi i mapingut për IVJK-të e njohura përmes procesit direkt të njohjes është përcaktuar sipas udhëzimit të paraqitur në aneksin 1 të kësaj rregullore.

Neni 6

Kërkesat e aplikimit për njohjen e një IVJK

1. BQK-ja me rastin e pranimit të aplikacionit të një IVJK-je, mund të njohë një IVJK duke u bazuar në plotësimin e kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore.
2. IVJK do të përgatitë aplikacionin për njohje në bashkëpunim me bankat që kanë interesa të përbashkëta në njohjen e kësaj IVJK-je. Aplikacioni për njohje duhet të përcillet me dokumentacionin e kërkuar që dëshmon pajtueshmërinë me kriteret e përshkruara me këtë rregullore.
3. Në rastet kur BQK-ja e njeh një IVJK duke mos e zbatuar procesin e saj të vlerësimit, për pajtueshmërinë e një IVJK me kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, atëherë BQK-ja do t'i shqyrtojë rastet individualisht se çfarë informacioni duhet të sigurojë një IVJK në aplikacionin e saj me shkrim.
4. Me përjashtim nga ajo se çfarë është përcaktuar në pikën 2.2 të nenit 3, një IVJK e njohur nga autoriteti kompetent i një shteti anëtar në Bashkim Evropian, së bashku me aplikacionin duhet të sigurojë dokumentacionin i cili dëshmon për njohjen e kësaj IVJK-je nga autoriteti kompetent.
5. Në rastet e njohjeve direkte duhet të plotësohen të gjitha kërkesat dhe të sigurohet informacioni i përcaktuar me aneksin 2 të kësaj rregulloreje.
6. BQK-ja mund të kërkojë dokumentacion shtesë nëse e sheh të nevojshme, në marrjen e vendimit të saj rreth aplikacionit.

Neni 7

Monitorimi i IVJK-ve të pranuar

1. Një IVJK e pranuar ka për obligim në mënyrë të vazhdueshme të përmbushë kriteret të cilat i janë kërkuar gjatë procesit të njohjes.
2. BQK-ja do të monitorojë përmbushjen e kriterëve të cilat janë marrë si bazë për dhënien e aprovimit për njohjen e vlerësimeve kreditore të përcaktuara nga IVJK-ja.
3. BQK-ja mund të kërkojë nga IVJK-ja e pranuar dhe bankat, informata të rëndësishme për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të cilat kanë qenë bazë për vendimin e aprovimit për përdorimin e vlerësimeve kreditore të përcaktuara nga ajo IVJK.

Neni 8

Tërheqja e njohjes së IVJK-së

1. BQK-ja mund të tërheqë njohjen e IVJK-së, në rastet kur:
 - 1.1.një IVJK e pranuar dështon të jetë në pajtueshmëri me kriteret e njohjes të përcaktuara në këtë rregullore;
 - 1.2.një IVJK e pranuar që është njohur nga BQK-ja sipas metodës indirekte të njohjes, nuk do të jetë më e pranuar si e tillë nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian.

Neni 9

Përdorimi i vlerësimeve kreditore nga IVJK-të për përcaktimin e peshave të rrezikut

1. Kërkesat e përgjithshme

- 1.1. Një bankë mund të emërojë një apo me shumë IVJK për të përcaktuar peshimin e rrezikut ndaj mjeteve dhe zërave jashtëbilancor.
- 1.2. Një bankë mund të revokojë emërimin e një IVJK-je. Nëse ka tregues konkret se qëllimi themelor i revokimit është për të reduktuar kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit, banka duhet të dëshmoj arsyet e revokimit.
- 1.3. Vlerësimet kreditore nuk duhet të përdoren në mënyrë selektive.
- 1.4. Një bankë mund të përdorë vlerësime të kërkuara dhe vlerësime të dhëna nga IVJK-të e pranuar.

2. Vlerësimi kreditor i IVJK-së

Një bankë duhet t'ju përmbahet kërkesave në vijim, gjatë përdorimit të vlerësimit kreditor të një IVJK-je:

- 2.1. Banka e cila për një klasë të caktuar të mjeteve, vendos të përdorë vlerësimet kreditore të realizuara nga një IVJK, duhet të përdorë këto vlerësime kreditore në mënyrë konsekuente për të gjitha ekspozimet që përfshihen në atë klasë;
- 2.2. Banka e cila vendos të përdorë vlerësimet kreditore të realizuara nga një IVJK, duhet t'i përdorë ato në mënyrë të vazhdueshme dhe konsistente gjatë gjithë kohës;
- 2.3. Banka mund të përdorë vetëm vlerësimet kreditore të IVJK-ve, të cilat marrin parasysh shumën e plotë të borxhit, si kryegjënë ashtu edhe interesin;
- 2.4. Në rastet kur, për një kërkesë ekziston vetëm një vlerësim kreditor nga një IVJK e emëruar, ai vlerësim i rrezikut kreditor duhet të përdoret për të përcaktuar peshën e rrezikut për atë kërkesë;

- 2.5. Në qoftë se për një kërkesë të vlerësuar ekzistojnë dy vlerësime kreditore nga dy IVJK dhe ato dy vlerësimet i korrespondojnë peshave të ndryshme të rrezikut, banka duhet të përdorë vlerësimin i cili korrespondon me peshën më të madhe të rrezikut për atë kërkesë;
 - 2.6. Në qoftë se për një kërkesë të vlerësuar ekzistojnë më shumë se dy vlerësime kreditore nga IVJK të pranuar, banka duhet të konsiderojë dy vlerësimet të cilat korrespondojnë me dy peshat më të ulëta të rrezikut. Nëse dy peshat më të ulëta të rrezikut janë të ndryshme, atëherë do të përdoret vlerësimi i cili korrespondon me peshën më të lartë të rrezikut dhe nëse dy peshat më të ulëta të rrezikut janë të njëjta, banka duhet të përdorë atë peshë rreziku.
3. Pavarësisht nga paragrafi 2 i këtij neni, banka nuk mund të zgjedhë një IVJK të pranuar e cila është:
 - 3.1. Filialë (person i varur juridik) e bankës;
 - 3.2. Entitet mëmë i bankës; apo
 - 3.3. Entitet në të cilin banka në mënyrë direkte apo indirekte është pjesëmarrëse ose së bashku me bankat e tjera, në mënyrë direkte apo indirekte posedon më shumë se 50% të shumës së përgjithshme të aksioneve apo të drejtave të votimit për atë entitet.
 4. Banka është e obliguar që, me procedurat e brendshme të saj, të përcaktojë metodën e përzgjedhjes së një IVJK të njohur dhe përdorimit të vlerësimeve kreditore.

Neni 10

Vlerësimi kreditor për emetuesin dhe për emetimin

1. Banka në rastet kur ekziston një vlerësim i rrezikut për një program ose subjekt në të cilën bën pjesë instrumenti, që përbën ekspozimin, do të përdorë këtë vlerësim të rrezikut kreditor për të përcaktuar peshën e rrezikut për këtë instrument.
2. Banka në rastet kur nuk ka një vlerësim të drejtpërdrejtë të zbatueshëm të rrezikut kreditor për një instrument të caktuar, por ekziston një vlerësim i rrezikut kreditor për një program apo subjekt, të cilës nuk i përket instrumenti që përbën ekspozimin, ose ekziston një vlerësim i përgjithshëm për emetuesin, do të përdorë këtë vlerësim të rrezikut kreditor, në qoftë se ky vlerësim:
 - 2.1. Prodhon një peshë më të lartë të rrezikut se që parashihet dhe ekspozimi në fjalë renditet, të paktën, në të njëjtën shkallë (*pari passu*) ose *junior* në të gjitha aspektet me programin specifik të emetimit ose subjektit ose me ekspozimet *senior* të pasiguruara të emetuesit;
 - 2.2. Prodhon një peshë rreziku më të ulët dhe ekspozimi në fjalë renditet në të njëjtën shkallë (*pari passu*) ose *junior* në të gjitha aspektet me programin specifik të emetimit ose subjektit ose me ekspozimet *senior* të pasiguruara të emetuesit;
3. Për të gjitha rastet e tjera, ekspozimi duhet të trajtohet si jo i vlerësuar.

4. Vlerësimet e rrezikut kreditor për një entitet në kuadër të një grupi të ndërlidhur biznesor, nuk mund të përdoren për t'i peshuar me rrezik entitetet e tjera brenda grupit të njëjtit.

Neni 11

Vlerësimet kreditore afatshkurtra

1. Vlerësimet kreditore afatshkurtra mund të përdoren vetëm për aktivet dhe zërat jashtëbilancor afatshkurtër që përbejnë ekspozime ndaj bankave dhe shoqërive të tjera tregtare (korporatave).
2. Çdo vlerësim afatshkurtër kreditor do të zbatohet vetëm për pozicionin të cilit i referohet dhe nuk do të përdoret për të nxjerrë peshat e rrezikut për ndonjë pozicion tjetër, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:
 - 2.1. Nëse një instrumenti financiar afatshkurtër të vlerësuar, i është caktuar një peshë rreziku 150%, atëherë për të gjitha ekspozimet e pasiguruara dhe të pavlerësuara, afatshkurtra apo afatgjata ndaj atij debitorit, do të përdoret një peshë rreziku 150%.
 - 2.2. Nëse një instrumenti financiar afatshkurtër të vlerësuar i është caktuar një peshë rreziku 50%, atëherë për çdo ekspozim afatshkurtër të pavlerësuar, do të përdoret një peshë rreziku jo më e ulët se 100%.

Neni 12

Vlerësimi për pozicionet në valutën vendore ose të huaj

1. Një vlerësim kreditor që i referohet një pozicioni në valutën vendore të debitorit, nuk mund të përdoret për të nxjerrë peshën e rrezikut për një tjetër ekspozim ndaj të njëjtit debitor, e cila është e shprehur në një valutë të huaj.
2. Kur lind një ekspozim si rrjedhojë e pjesëmarrjes së një banke në një kredi të një banke shumëpalëshe për zhvillim, të cilës i është njohur në treg statusi si kreditor i preferuar, BQK-ja mund të lejojë bankën/at të përdorin për qëllime të peshave të rrezikut, vlerësimin kreditor të pozicioneve në valutën vendore të debitorit.

Neni 13

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Bankat.

Neni 14
Dispozitat kalimtare

Bankat duhet të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e kësaj rregulloreje brenda tre (3) muajve nga data e hyrjes në fuqi.

Neni 15
Anekset

Pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje janë aneksi 1 dhe aneksi 2.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 shkurt 2016.

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Dr. Prof. Bedri Peci

ANEKS 1

Procesi i mapingut për njohjet direkte të IVJK-ve

1. Në mënyrë që të krahasojë dhe të ndërlidhë klasat përkatëse të rrezikut kreditor të përcaktuara sipas vlerësimit kreditor të secilës IVJK, BQK-ja do të marrë parasysh faktorët sasiorë, të tillë si normat e dështimit afatgjatë, të lidhur me të gjitha pozicionet me të njëjtin vlerësim të rrezikut kreditor. Për IVJK-të e reja dhe për ato që kanë regjistruar vetëm një seri të shkurtër të të dhënave të dështimit, BQK-ja kërkon prej tyre një vlerësim të normës së dështimit afatgjatë për të gjitha pozicionet e caktuara në të njëjtin vlerësim kreditor;
2. Në mënyrë që të krahasojë dhe ndërlidhë klasat përkatëse të rrezikut kreditor të përcaktuara sipas vlerësimit kreditor të secilës nga IVJK-të, BQK-ja do të marrë parasysh faktorët cilësorë, të tillë si: grupi i një lloji të veçantë të emetuesve të cilin IVJK-ja e mbulon, gamën e vlerësimeve kreditore të cilat IVJK-ja përcakton, kuptimi i secilës kategori të vlerësimit kreditor të caktuar, si dhe përkufizimin për dështimin “default” që IVJK-ja përdor.
3. BQK-ja krahason normat e dështimit, të realizuara nga secili vlerësim kreditor i një IVJK-je të veçantë dhe me një standard të ndërtuar mbi bazën e përvojës së normave të dështimit (*default*) nga IVJK-të e tjera, për një kategori të emetuesve, për të cilët BQK-ja vlerëson se përfaqësojnë një nivel të barasvlershëm të rrezikut kreditor.
4. BQK-ja për rastet kur konsideron se normat e dështimit për vlerësimin kreditor të një IVJK-je, janë materialisht dhe sistematikisht më të larta se standardi i ndërtuar, cakton një nivel/shkallë më të lartë të cilësisë së vlerësimit kreditor, bazuar në shkallët e përcaktuara të kualitetit për vlerësimin e rrezikut kreditor të IVJK-së.
5. BQK-ja për rastet kur ka rritur peshën e rrezikut të lidhur me vlerësimin e rrezikut kreditor të një IVJK-je të veçantë dhe nëse IVJK-ja dëshmon se normat e dështimit të realizuara, bazuar në përvojën e saj të vlerësimeve kreditore, nuk janë materialisht dhe sistematikisht më të larta se standardi, mund të vendosë dhe të rikthejë nivelin/shkallën e cilësisë së vlerësimit kreditor fillestar, në nivelin e cilësisë së vlerësimit kreditor të dhënë nga IVJK-ja.
6. BQK-ja do të ndërlidhë (sipas *mapping-ut*) vlerësimet kreditore nga një IVJK në këtë mënyrë:
 - 6.1. Duke përdor ndërlidhje (mapping) direkte;
 - 6.2. BQK-ja vazhdimisht do të monitorojë adekuatshmërinë e ndërlidhjes/mapping të vlerësimit kreditor, si dhe ndryshimet që pësojnë në mapping dhe nëse konsideron se mapping nuk është më adekuate, atëherë BQK-ja do të bëjë rindërlidhjen e shkallëve të përdorura (*re-mapping*).
 - 6.3. BQK-ja do të përdorë normën e akumuluar të dështimit trevjeçar - *Cummulative Default Rate* (në vijim: *CDR tre vjeçare*) dhe të dhënat e tjera sasiore dhe cilësore për të ndërlidhur vlerësimet kreditore.

6.4 Për ndërlidhjen e vlerësimeve kreditore afatgjata, BQK-ja krahason mesataren dhjetëvjeçare të CDR-së trevjeçare, për të gjitha subjektet ligjore për të cilat është caktuar vlerësimi i njëjtë kreditor afatgjatë nga institucioni për vlerësimin kreditor me referencë afatgjate trevjeçare të CDR-së për nivelin përkatës të cilësisë kreditore, sipas tabelës në vijim (Tabela 1):

Tabela 1

Niveli/shkalla e cilësisë kreditore	1	2	3	4	5
CDR-ja trevjeçare e vlerësimit afatgjatë kreditor	0.10%	0.25%	1.00%	7.50%	20,00%

6.5 Sipas ndërlidhjes në pikën 6.4 më lartë, dy CDR-të trevjeçare më të fundit për të gjitha subjektet ligjore të caktuara në të njëjtin vlerësim kreditor afatgjatë nga institucioni i vlerësimit kreditor, do të krahasohet me nivelin standard për CRD-të trevjeçare për nivelin përkatës të cilësisë kreditore, sipas tabelës në vijim (tabela 2):

Tabela 2

Niveli i cilësisë kreditore	1	2	3	4	5
Monitorimi i CDR-së trevjeçare	0.80%	1.00%	2.40%	11.00%	28.60%
Aktivizimi i CDR-së trevjeçare	1.20%	1.30%	3.00%	12.40%	35.00%

6.6 Me anashkalimin e pikës 6.4 më lartë, nëse institucioni i vlerësimit kreditor nuk posedon seri të gjatë të normës së dështimit, do të kalkulojë mesataren dhjetëvjeçare të CDR-së trevjeçare, si dhe parametrat e tjerë sasiorë, që përdoren në ndërlidhjen (*mapping*) e vlerësimeve kreditore.

6.7 BQK-ja së pari do t'i ndërlidhë vlerësimet afatgjata kreditore duke krahasuar mesataren dhjetëvjeçare aktuale apo të parashikuar të CDR-së trevjeçare të caktuar për vlerësimin kreditor me referencë afatgjatë të CDR-së trevjeçare për nivelin e duhur të cilësisë kreditore, siç është paraqitur në tabelën 1. Kjo ndërlidhje (*mapping*) vërtetohet duke përdorur nivelin e monitorimit të CDR-së standarde e trevjeçare dhe nivelin standard të aktivizimit të CDR-së trevjeçare për nivelin përkatës të cilësisë kreditore, sipas tabelës 2, në këtë mënyrë:

- a) Kur CDR-ja e fundit e caktuar për vlerësimin kreditor është mbi nivelin relevant të monitorimit, BQK-ja do të caktojë një nivel më pak të favorshëm të shkallës së cilësisë kreditore në krahasim atë të përcaktuar nga IVJK, nëse e përcakton se përvoja e dështimit më të lartë i atribuohet standardeve më të dobëta në vlerësimin e rrezikut kreditor.
- b) Kur dy CDR më të fundit të vlerësimit kreditor të caktuar janë mbi nivelin relevant të aktivizimit, BQK-ja mund të caktojë një shkallë më të ulët të cilësisë kreditore sesa ajo e caktuar nga IVJK, nëse presupozohet se standardet për vlerësimin e rrezikut kreditor të IVJK-së, ose janë shumë të ulëta ose nuk janë të aplikuara në mënyrë të përshtatshme.

7. Nënparagrafin 6.7 më lartë, nëse BQK-ja cakton një nivel më të lartë të cilësisë kreditore dhe në qoftë se IVJK-ja dëshmon se normat e dështimit për vlerësimin kreditor nuk dallojnë nga norma referente, BQK-ja mund të vendosë të rikthejë cilësinë kreditore fillestare, në nivelin/shkallën e vlerësimit të cilësisë kreditore të dhënë nga IVJK-ja.
8. BQK-ja në ndërlidhjen (*mapping-un*) e vlerësimit afatgjatë kreditor, përveç vlerësimeve kreditore trevjeçare, gjithashtu analizon edhe të dhënat e tjera nëse e konsideron të arsyeshme.
9. BQK-ja do të ndërlidhë vlerësimet afatshkurta kreditore duke u bazuar në rezultatet e mappingut të vlerësimeve afatgjata, si dhe në rezultatet e mappingut të vlerësimit afatshkurtër kreditor të një IVJK-je duke u bazuar në vlerësimin afatgjatë të kredisë.

ANEKS 2

Informatat bazike të aplikacionit *

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

- Lloji i aplikacionit: për përdorimin e vlerësimeve kreditore nga një IVJK për peshimin me rrezik të mjeteve sipas Qasjes së Standardizuar, apo peshimin me rrezik të sekjuritizimeve (securitizations).
- Segmentet e tregut në të cilat aplikuesi kërkon njohje.
- Lloji i vlerësimit të kredisë: i kërkuar (*solicited*) ose/dhe i dhënë (*unsolicited*), me një shpjegim të shkurtër mbi logjikën e politikës së vlerësimit.
- Autoritetet kompetente për të cilat aplikuesi kërkon njohje apo ka për qëllim të kërkojë njohje.
- Vendet ku IVJK-ja ushtron aktivitetin e tij.

Prezantimi i IVJK-së

- Një vështrim të strukturës ligjore të IVJK-së dhe grupit të cilit i takon: pronësia, degët (filialet) kryesore, shërbimet ndihmëse ose të tjera të ofruara etj. Informacioni mbi pronësinë duhet të përfshijë një listë të aksionarëve, që zotërojnë dhjetë apo më shumë përqind (10%) të kapitalit të IVJK-së. Ky limit mund të ndryshojë varësisht nga struktura e pronësisë së një IVJK-je.
- Numri i përgjithshëm i punonjësve të rregullt dhe me orar të plotë.
- Numri i përgjithshëm dhe përqindja e të hyrave nga klientët kryesorë dhe/ose abonentët (për shembull, klientët apo abonentët që zënë 5% ose më shumë të totalit të të ardhurave; kufiri mund të ndryshojë varësisht nga IVJK-ja).
- Informacioni financiar që tregon qëndrueshmërinë financiare të IVJK-së: pasqyrat financiare të IVJK-së për tre vitet e fundit dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme nëse janë të disponueshme, ose një letër mbështetëse nga subjekti mëmë.
- Informacion mbi kodin e sjelljes, nëse ky kod është në përputhje me standardet e pranuar të tregut ose me parimet e njohura ndërkombëtare.

Kriteret teknike

Aplikuesi duhet të përfshijë në aplikacionin e tij një përshkrim të procesit bazë të vlerësimit (*rating*)kreditor për secilin segment të tregut apo pozicion të sekjuritizimit dhe secilën zonë gjeografike në të cilën synon njohje. Aplikuesi nuk ka nevojë të paraqesë përgjigje të dyfishta dhe informacione për këtë pako të aplikimit, por duhet qartë të tregojë për secilin kriter të njohjes se çfarë e dallon një fushë të njohjes nga një tjetër.

BQK-ja shpreh interesim vetëm në informatat të cilat janë relevante për segmentin e tregut dhe/apo pozitën e sekjuritizimit për të cilin është dorëzuar aplikacioni.

METODOLOGJIA

1. Objektiviteti

Pyetje:

Si mund të siguroheni se metodologjia që përdoret për vlerësimin kreditor është rigoroze, sistematike dhe se i nënshtrohet vërtetimit (validitetit) duke u bazuar në përvojën historike?

Informacioni minimal që duhet t'i sigurohet BQK-së në mënyrë që të verifikohet se kriteret e njohjes janë të pranueshme:

1) Një përshkrim i detajuar i metodologjisë dhe proceseve të vlerësimit kreditor dhe se si është përcaktuar, zbatuar dhe ndryshuar kjo metodologji. Ky përshkrim duhet të përfshijë një përshkrim të proceseve të aplikuara për të siguruar zbatimin konsistent të metodologjive të vlerësimit kreditor, për të gjitha vlerësimet kreditorë, në mënyrë të veçantë, rolin e komisioneve vlerësuese dhe udhëzimeve që ato iu përmbahen, masën e përfshirjes së të dhënave nga subjektet vlerësuese, qasjen në informacionet jopublik etj.

2) Për secilën nga grupimet e mjeteve brenda të cilave aplikohet metodologjia bazike në mënyrë konsistente (për shembull financat e strukturuar, financat publike, subjektet tregtare) një përshkrim i detajuar i të dhënave sasiore: variablat kryesore, burimet e të dhënave, supozimet dhe teknikat sasiore të përdorura, shtrirja e të dhënave nga subjektet e vlerësuara etj.

3) Për secilën nga grupimet e mjeteve brenda të cilave aplikohet metodologjia bazike në mënyrë konsistente (për shembull financat e strukturuar, financat publike, subjektet tregtare) një përshkrim i detajuar i të dhënave cilësore: në veçanti fushëveprimi i gjykimit cilësor, si për shembull në lidhje me strategjinë, planet e biznesit të subjekteve të vlerësuara etj.

4) Një përmbledhje, sipas zonave gjeografike, të ndryshimeve të konsiderueshme në metodologjitë bazë të përdorura.

5) Një përshkrim të metodologjisë të përdorur për të verifikuar saktësinë, konsistencën dhe fuqinë dalluese të sistemeve të klasifikimit, që shpalos detajet mbi rezultatet dhe konkluzionet e përfituara nga një analizë e tillë.

2. Pavarësia

Pyetje:

Si mund të siguroheni se pavarësia e metodologjisë është e pastër nga ndikimet e jashtme të politikës apo kufizimet nga presionet ekonomike, që mund të ndikojnë në vlerësimin e një subjekti apo instrumenti financiar?

Informacioni minimal që duhet t'i sigurohet BQK-së në mënyrë që të evidentohet se kriteret e njohjes janë të pranueshme:

1) Një përshkrim i procedurave që synojnë sigurimin e vlerësimeve të drejta dhe objektive kreditorë: mekanizmat për të identifikuar, parandaluar, administruar dhe eliminuar konfliktet aktuale apo të mundshme të interesit.

2) Një përshkrim i masave mbrojtëse në fuqi në rastet kur aksionarët ose palët e tjera në grupin e palëve të ndërlidhura janë të vlerësuar.

3) Deklaratë mbi ekzistencën e një funksioni të kontrollit të brendshëm dhe/ose që ekzistojnë mjete për të siguruar që procedurat e brendshme të vlerësimit kreditor zbatohen në mënyrë efektive.

4) Deklaratën mbi aftësitë profesionale të duhura dhe të nevojshme të anëtarëve të grupeve

dhe komiteteve të vlerësimit, duke përfshirë ekspertizën dhe përvojën në vlerësimin kreditor, si dhe përsosjen e tyre nëpërmjet programeve adekuate të trajnimit.

5) Një përshkrim i karakteristikave kryesore të kodit të brendshëm të sjelljes së IVJK-së.

6) Deklaratën mbi politikën e kompensimit të stafit të përfshirë në vlerësimin kreditor, e cila nuk do të ndikojë negativisht në dhënien e vlerësimeve kreditore të pavarura dhe objektive (për shembull, vërtetim se kompensimi i analistëve nuk është i lidhur me vendimet e vlerësimeve kreditore, pagesat nga subjektet e vlerësuara, ose të ardhurat nga klientët apo abonentët e IVJK-së).

7) Informacion i detajuar i politikës së tarifave dhe komisioneve të IVJK-së.

8) Deklaratën që personeli i përfshirë në procesin e vlerësimit kreditor nuk është angazhuar në marrëdhënie biznesi me subjektet e vlerësuara, që mund të pengojnë lëshimin e vlerësimeve të pavarura dhe me cilësi të lartë të vlerësimit të rrezikut kreditor.

3. Rishikimi i vazhdueshëm

Pyetje:

1) A i nënshtrohen rishikimit të vazhdueshëm vlerësimet kreditore të IVJK-së aplikuese, përmes një rishikimi i cili kryhet së paku një herë në vit për të gjitha aktivitetet e rëndësishme?

2) Deri në çfarë mase, vlerësimet tuaja kreditore janë të përgjegjshme ndaj ndryshimeve në kushtet financiare?

3) Çfarë procedura ekzistuese keni që sigurojnë se autoritetet kompetente janë të informuara me kohë për ndryshimet e rëndësishme dhe nëse po, cilat janë ato ndryshime?

Informacioni minimal që duhet t'i sigurohet BQK-së në mënyrë që të evidentohet se kriteret e njohjes janë të pranueshme:

1) Informacion i përgjithshëm mbi shqyrtimin e vlerësimeve kreditore (për shembull, procesi i kryer në vend, karakteristikat kryesore, fusha e veprimit, frekuenca dhe ekipet/grupet e stafit të përfshirë, mjetet e përdorura, trajtimi, fazat kryesore të procesit të monitorimit, rifreskimi i të dhënave, informacioni nga subjektet e vlerësuara i marrë në shqyrtim, sistemet automatike paralajmëruese, mekanizmat që lejojnë gabime sistematike në vlerësimet kreditore, të cilat reflektohen në ndryshime të mundshme në metodën e vlerësimeve etj.).

2) Një përmbledhje e rezultateve të rishikimeve të kryera.

3) Informacion mbi ekzistencën e një sistemi të ritestimit “*back-testing*” të instaluar dhe që funksionon prej të paktën një vit.

4) Lista e kontakteve me menaxhmentin e lartë, të subjekteve të vlerësuara (ky informacion të sigurohet nëse kërkohet nga autoriteti kompetent).

4. Transparenca dhe shpalosja/publikimi

Pyetje:

Si dhe kujt i shpalosni parimet e metodologjisë të cilën e përdorni?

Informacioni minimal që duhet siguruar BQK-së në mënyrë që të evidentohet se kriteret e njohjes janë të pranueshme:

1) Dëshmi se janë publikuar parimet e metodologjisë së përdorur nga IVJK-ja për formulimin e vlerësimeve kreditore.

2) Përshkrimi i mënyrave të përdorura për të bërë publike metodologjitë dhe kushtet për qasjen në vlerësimet kreditore nga ana e të gjithë përdoruesve të mundshëm.

3) Një përshkrim të politikave të transparencës, lidhur me llojin e vlerësimeve kreditore: të dhëna (*unsolicited*) apo të kërkuara (*solicited*).

VLERËSIMET INDIVIDUALE KREDITORE

5. Besueshmëria dhe pranueshmëria në treg

Pyetje:

Si mund të dëshmoni besueshmërinë tuaj dhe pranimin në treg?

Informacioni minimal që duhet t'i sigurohet BQK-së në mënyrë që të evidentohet se kriteret e njohjes janë të pranueshme:

1) Çdo evidencë që vërteton/demonstron mbështetjen e tregut në vlerësimet kreditore, të tilla si: pjesa e tregut, numri i subjekteve të vlerësuara, sa gjatë ka qenë aktive në treg IVJK-ja, të ardhurat e përfuara nga aktiviteti i vlerësimeve.

6. Transparenca dhe shpalosja/publikimi

Pyetjet:

1) Si mendoni, që vlerësimet individuale kreditore janë të qasshme me kushte të barabarta dhe së paku për të gjitha institucionet që kanë interesa legjitime për këto vlerësime kreditore?
2) Në veçanti, si mendoni që vlerësimet kreditore janë të qasshme me kushte të barabarta si për palët vendore dhe ato të huaja (jovendore) që kanë interesa legjitime për këto vlerësime kreditore?

Informacioni minimal që duhet t'i sigurohet BQK-së në mënyrë që të evidentohet se kriteret e njohjes janë të pranueshme:

1) Një përshkrim i detajuar i procedurave në fuqi për publikim (shpalosjet).

MAPING

Pyetje: Nuk ka

Informacioni minimal që duhet t'i sigurohet BQK-së në mënyrë që të kryejë ndërlidhjen (*mapping-un*) e vlerësimit kreditor të ekspozimeve përveç pozicioneve të sekjuritizimit:

1) Përkufizimi i dështimit (*default*).

2) Norma e akumuluar e dështimit (*Cummulative Default rate – CDR*) për një periudhë prej më shumë se tre vite për secilën kategori të vlerësimit kreditor (të sigurohet në baza vjetore, sene qoftë se IVJK-ja do të pranohet) dhe të paktën dy CDR-të më të fundit nëse janë të disponueshme.

3) Mesatarja 10 vjeçare e CDR-ve 3 vjeçare. Nëse kjo nuk është e disponueshme, një tregues i pritshmërisë së IVJK-së lidhur me normën e dështimit për instrumentet afatgjate.

4) Një informacion mbi probabilitetin e synuar të dështimit për çdo kategori të vlerësimit kreditor, nëse është përdorur një probabilitet i synuar i dështimit.

5) Përshkrimi i metodologjisë për llogaritjen e CDR-së: përzgjedhja e grupit/*pool* (statike kundrejt asaj dinamike/e rregulluar, përkufizimi i dështimit, mbledhja e dështimeve (mekanizmi i përshkimeve).

6) Rëndësia statistikore e normave të dështimit.

7) Karakteristikat dinamike të metodologjisë së vlerësimit (në një kohë të caktuar apo gjatë tërë ciklit të metodologjisë).

8) Kuptimi i kategorive të vlerësimit kreditor.

9) *Gama* e vlerësimit kreditor që përcakton IVJK-ja.

10) Afati kohor i vlerësimeve kreditore.

11) Matricat tranzitore.

12) Mbulimi gjeografik.

Informacioni minimal që duhet t'i sigurohet BQK-së në mënyrë që të kryejë

ndërlidhjen (*mapping-un*) e vlerësimit kreditor të pozicioneve të sikjuritizimit:

- 1) Përkufizimi i dështimit në bazë të të cilit llogariten normat e dështimit.
- 2) Të dhënat e performances së vlerësimit, të shoqëruara me një sqarim të veçorive kryesore të saj (për shembull arsyet themelore për përcaktimin e periudhës kohore mbi të cilën është kryer studimi dhe sesi vlerësimi kreditor i lëshuar afekton studimet e performancës së vlerësimeve, si llogaritet periudha sezonale).
- 3) Të dhënat për humbjet dhe pjesët e rikuperuara në rast të dështimeve.
- 4) Informacioni që i referohet pikës 8 deri në pikën 12 më lartë.

*CEBS – Komiteti i Mbikëqyrjes Bankare Evropiane – Udhëzuesi për Njohjen e IVJK-ve.